



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZP.Anr.58/2026

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Violeta Husaj Rugova - kryesuese, Hajriz Hoti dhe Bujar Muzaqianëtarë, duke vendosur lidhur me ankesën e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Komuna Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026 i datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 07 Qershor 2026, në seancën e panelit të mbajtur, më datë 01.07.2026, merr këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa ZP.Anr.58/2026, e datës 29.06.2026, e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr. 01/1375-2026 i datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 07 Qershor 2026.

A r s y e t i m

Më datë 29.06.2026, PZAP-i, ka pranuar ankesën ZP.Anr.58/2026 nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të KQZ-së, Nr. 01/1375-2026 i datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 07 Qershor 2026, përmes të cilës kanë kërkuar verifikimin e ligjshmërisë së përdorimit të votave të subjektit politik "Za slobodu, pravdu i opstanak", të realizuara në qendrat e votimit të vendbanimeve boshnjake të Komunës së Prizrenit, për sigurimin e vendit të garantuar të destinuar për përfaqësimin e komunitetit serb në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Dyshimi i bazuar rrjedh nga fakti se votat e lartpërmendura janë realizuar në mjedise ku, sipas të dhënave zyrtare demografike, komuniteti serb nuk ka prani reale apo relevante, prandaj ekziston nevoja që PZAP-i të verifikojë nëse përdorimi i tyre për përlllogaritjen e mandatit të garantuar ka çuar në keqpërdorimin e mekanizmit kushtetues të vendeve të garantuara dhe në cenimin e përfaqësimit autentik të komuniteteve joshumicë.

Prandaj, propozohet që PZAP ta aprovojë këtë ankesë si të bazuar në pjesën që ka të bëjë me verifikimin e përdorimit të votave të subjektit politik “Za slobodu, pravdu i opstanak” për realizimin e vendit të garantuar; të urdhërojë verifikim të hollësishëm të rezultateve në qendrat e votimit 2043, 2044, 2045, 2046, 2049 dhe 2071 në komunën e Prizrenit; të urdhërojë rinumërimin dhe verifikimin e të gjitha fletëvotimeve të vlefshme, formularëve të harmonizimit të rezultateve, procesverbaleve të këshillave të vendvotimeve dhe materialit përcjellës zgjedhor për qendrat e përmendura të votimit; të kërkojë nga KQZ-ja dokumentacionin e plotë për certifikimin e subjektit politik “Za slobodu, pravdu i opstanak”, përfshirë deklarin nëse subjekti ka aplikuar për vendet e garantuara dhe për cilin komunitet; të konstatojë nëse ka ardhur deri te keqpërdorimi i mekanizmit kushtetues të vendeve të garantuara përmes mbështetjes vendimtare në vota nga mjediset ku komuniteti për të cilin garantohet vendi nuk ka prani reale demografike; në rast të konstatimit të shkeljes, të urdhërojë masa korrigjuese në përputhje me ligjin, përfshirë korrigjimin e rezultateve, përjashtimin e votave kontestuese nga përlllogaritja për realizimin e vendit të garantuar, anulimin e rezultateve në vendvotimet konkrete nëse janë plotësuar kushtet ligjore, si dhe çdo masë tjetër që PZAP-i e vlerëson të domosdoshme për mbrojtjen e integritetit të procesit zgjedhor dhe përfaqësimit autentik të komuniteteve; dhe deri në përfundimin e procedurës dhe vendosjen për këtë ankesë, të rekomandojë ose të urdhërojë që të mos ndërmerren veprime të pakthyeshme lidhur me konfirmimin e mandatit që varet nga modeli i kontestuar i votimit.

Kërkesat e tilla mbështet në faktin se votat të cilat janë realizuar në mjedise ku sipas të dhënave zyrtare demografike, komunitetit serb nuk ka prani reale apo relevante. Pala ankuese pretendon se ekziston nevoja që PZAP të verifikoj nëse përdorimi i këtyre votave në përlllogaritjen e mandatit të garantuar ka qar në keqpërdorimin e mekanizmit kushtetues që ka të bëjë me vendet e garantuara dhe me cenimin e përfaqësimit autentik të komunitetit jo shumicë. Nga arsyet e paraqitura në ankese ka propozuar që ankesa të aprovohet si e bazuar.

Si provë kanë bashkangjitur anekset: Aneksi 1 - Ekstrakt nga regjistrimi i popullsisë ASK/ReKos 2024 për vendbanimet Reçan, Lubinjë e Epërme, Lubinjë e Poshtme, Manastiricë, Gërçar dhe Planjanë, me strukturën etnike sipas vendbanimit; Aneksi 2 - Rezultatet e zgjedhjeve të parakohshme parlamentare të vitit 2026 sipas qendrave të votimit dhe vendvotimeve për subjektin politik “Za slobodu, pravdu i opstanak”; Aneksi 3 - Tabela krahasuese: votat e ZSPO-së, votat e Listës Serbe dhe numri i pjesëtarëve të komunitetit serb sipas ASK/ReKos 2024; Aneksi 4- Dispozitat relevante të Kushtetutës së Republikës së Kosovës dhe Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme; dhe Aneksi 5- Pamje ekrani/ekstrakte nga faqja zyrtare e KQZ-së për çdo qendër votimi të kontestuar.

Në përgjigje në ankesë KQZ pas shqyrtimit të ankesës dhe pretendimeve të palës ankuese jep sqarimet dhe përgjigjet se liria dhe e drejta e votës në Republikën e Kosovës garantohen me Kushtetutë dhe me legjislacionin që rregullon proceset zgjedhore, përkatësisht Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme (LZP). Nga kjo rezulton qartë se sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës nuk e kushtëzon të drejtën e votës me përkatësinë etnike të votuesit, Republika e Kosovës nuk është e organizuar në zona zgjedhore mbi baza etnike dhe legjislacioni në fuqi nuk parashikon asnjë mekanizëm që e lidh ose kushtëzon votën me identitetin e etnik të qytetarit. E drejta e votës përfaqëson një akt individual të shprehjes së lirë të vullnetit politik të

qytetarit dhe, si e tillë nuk mund të paragjykohej, kufizohet apo vlerësohet në bazë të përkatësisë së tij etnike të votuesit. Çdo interpretim i kundërt që synon të lidh ose vlerësoj rezultatin zgjedhor mbi baza etnike është në kundërshtim me parimet kushtetuese të barazisë, lirisë së votës dhe karakterit universal të së drejtës së votës, të garantuara me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe LZP. Pretendimet e palës ankuese se rezultatet zgjedhore në qendrat e votimit të specifikuar në ankesë nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë nuk përbëjnë bazë ligjore për kontestimin e vlefshmërisë së votave apo rezultatit zgjedhor. Lista e Votuesve (LV) nuk përmban dhe as nuk mund të përmbajë të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve. Në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna që kanë të bëjnë me etninë e qytetarëve. Po ashtu, Rregullorja Zgjedhore nr.03/2024 për Krijimin, Kundërshtimin dhe Konfirmimin e Listës së Votuesve përcakton qartë se (LV) përmban vetëm të dhëna identifikuese dhe administrative, si emri dhe mbiemri i votuesit, numri personal i identifikimit, data e lindjes, adresa e vendbanimit, si dhe të dhëna të tjera të nevojshme për identifikimin e votuesit dhe ushtrimin e së drejtës së votës, por jo të dhëna që lidhen me përkatësinë etnike të qytetarëve. Për rrjedhojë, nuk ekziston asnjë bazë faktike dhe ligjor për të nxjerrë përfundime ose për të ngritur pretendime lidhur me votuesit mbi bazën e përkatësisë së tyre etnike.

Në këto rrethana, KQZ vlerëson se ankesa nuk mbështetet në bazë të mjaftueshme juridike dhe nuk dëshmon gjetjen e shkeljeve të procesit zgjedhor. Rezultati zgjedhor është pasqyrim i votës së lirë dhe të fshehtë të qytetarëve dhe, si i tillë, gëzon mbrojtje kushtetuese.

Paneli, pasi që shqyrtoi dhe vlerësoi pretendimet ankimore, përgjigjen në ankesë dhe shkresat e lëndës ka gjetur se:

- Ankesa është e pabazuar.

Pretendimet ankimore të parashtrueses së ankesës se sipas rezultateve zyrtare të KQZ-së, subjekti politik Za Slobodu Pravdu i Opstanak, në mënyrë të çrregullt ka fituar vota në zonat ku nuk ka anëtarë të komunitetit serb, dhe se e njëjta ka arritur numrin e votave në mjediset boshnjake të Komunës së Prizrenit, përkatësisht në vendet e votimit: 2043 - Reçan - 18 vota, 2044 - Lubinjë e Epërme - 76 vota, 2045 - Lubinjë e Poshtme - 27 vota, 2046 - Manastiricë - 19 vota, 2049 - Gërçar - 17 vota dhe 2071 - Planjanë - 46 vota, sipas vlerësimit të panelit janë të pabazuara, për faktin se e drejta e votës ka dy parime kryesore barazinë dhe fshehtësinë e saj dhe lista e votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve për shkak se do të mund të cenohen këto parime.

Paneli vlerëson se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit, ngase i tërë territori i Republikës së Kosovës është një zonë zgjedhore sipas LZP-së, andaj për Panelin këto pretendime janë ta pabazuara duke iu referuar nenit 6 par. 2 i LZP-së, që parasheh se “*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë*”, duke mos paragjykuar se si një votues zgjedhë të votojë një subjekt politik të caktuar.

Paneli sqaron se në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë ligjore mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Bazat përkatëse ligjore dhe mënyra e shpalljes së votave të pavlefshme është specifikisht e përcaktuar në Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Rregullores Zgjedhore Nr.12/2024 të aplikueshme në rastin konkret. Paneli thekson se bazuar në ligjet e aplikueshme të Republikës së Kosovës, shpallja e pavlefshme e votave, duhet të jetë e bazuar në bazë të qartë ligjore.

Po ashtu me dispozitën e nenit 45.1 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës është paraparë që: *“Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. Ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: “Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.”* Në rastin konkret Paneli nuk mund të pranojë një pretendim dhe një kërkesë të tillë që të anulohen zgjedhjet dhe të shpallen të pavlefshme fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore, pasi që çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar dhe të ketë mbështetje ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, dhe rregullativa e KQZ-së, për të anuluar zgjedhjet /dhe për të shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Për një situatë të tillë, ka edhe praktikë nga ana e Gjykatës Kushtetuese e Republikës së Kosovës, e cila me Aktgjykimin në rastin KI69/2021, ndër të tjera ka sqaruar se: Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime.

Paneli rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit, sepse as Ligji dhe as Rregullativa e KQZ-së, nuk përcaktojnë asnjë kriter tjetër mbi bazën e të cilit mund të shpallen të pavlefshme fletëvotimet dhe aq më pak kriter të bazuar në përkatësi etnike të votuesve. Po ashtu sipas vlerësimit të panelit kërkesa për anulim të votave, përkatësisht shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve në VV: 2043 - Reçan, 2044 – Lubinjë e Epërme, 2045 – Lubinjë e Poshtme, 2046 - Manastiricë, 2049 - Gërçar dhe 2071 - Planjanë, të paraqitura në tabelën si në ankesë, është e pa bazë edhe për faktin se ky rezultat zgjedhor nuk ka rezultuar në cenimin e të drejtave të parashtruesit të kërkesës për t’u zgjedhur deputet i Kuvendit të Republikës së Kosovës siç është e garantuar përmes paragrafit 1 të nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës.

Nga të gjitha të lartcekurat, Paneli vlerësoi se ankesa e parashtruar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), është e pabazuar, pasi që nuk ka

bashkangjitur prova bindëse që do të dëshmonte pretendimet ankimore, në mbështetje të nenit 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: "*Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*". Andaj, Paneli e refuzoi ankesën pasi që pala ankuese nuk e bëri të besueshme me prova bindëse dhe nuk ka mundur të vërtetoj se votat për komunitetin boshnjak janë të manipuluar dhe të orkestruara, por se theksimet e saj në ankesë janë vetëm deklarime dhe të pa argumentuara.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZP.Anr.58/2026 më datën 01.07.2026

Kryesuese e Panelit
Violeta Husaj Rugova



Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

AA.nr.31/2026

GJYKATA SUPREME NË PRISHTINË - kolegji i përbërë nga gjyqtarët: Faton Bajrami, kryetar, Faton Ademi dhe Lumni Sallauka, anëtarë, duke vendosur sipas ankesës së Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.A.nr.58/2026, të datës 01.07.2026, për shkak të përdorimit të votave të subjektit politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” - ZSPO, të realizuara në qendrat e votimit të vendbanimeve boshnjake të komunës së Prizrenit, për llogaritjen e vendit të garantuar të destinuar për përfaqësimin e komunitetit serb, në zgjedhjet e parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura më 07.06.2026, në seancën e mbajtur më datë 06.07.2026, merr këtë:

A K T G J Y K I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa e Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimit të Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), ZP.A.nr.58/2026, të datës 01.07.2026.

A r s y e t i m

Me vendimin e Panelit Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa ZP.Anr.58/2026, të datës 01.07.2026, është vendosur: “Refuzohet e pabazuar ankesa ZP.A.nr.58/2026, e datës 01.07.2026, e parashtuar nga Emilija Rexhepi, nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, paraqitur kundër vendimi të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), nr.01/1375-2026, i datës 27.06.2026 për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvend të Republikës së Kosovës të mbajtura me datën 07 Qershor 2026.”.

Kundër vendimit të lartpërmendur, Emilija Rexhepi, në afat të lejuar ligjor ka paraqitur ankesë në Gjykatën Supreme, duke propozuar që Gjykata Supreme të aprovojë ankesën e Emilija Rexhepit si të bazuar, të shfuqizojë vendimin e PZAP- së, ZP.A.nr.58/2026 dhe ta kthejë lëndën në rivendosje, me udhëzime të qarta juridike që do ta obligojnë PZAP-në ta trajtojë lëndën si çështje kushtetuese dhe ligjore të mbrojtjes së vendeve të garantuara, përfaqësimit autentik dhe standardit të barabartë juridik.

PZAP në përgjigje në ankesën e paraqitur të Emilija Rexhepit, kundër vendimit të tij të lartpërmendur, i kontestoi në tërësi thëniet a ikimore të paraqitëses të ankesës dhe propozoi që



ankesa e ankueses Emilija Rexhepi të refuzohet si e pabazuar, ndërsa të vërtetohet vendimi ZP.Anr.58/2026, i datës 01.07.2026.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerësoi ligjshmërinë e vendimit të kontestuar, në kuptim të pretendimeve ankimore, përgjigjes në ankesë, dhe pas shqyrtimit edhe të shkresave të lëndës, gjeti se:

Ankesa është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rezulton se më datë 29.06.2026, PZAP-i ka pranuar ankesën e Emilija Rexhepit nga radhët e subjektit politik Nova Demokratska Stranka (NDS), me seli në Prizren, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.01/1375-2026, të datës 27.06.2026, për shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura me datë 07.06.2026. Në ankesë është kërkuar verifikimi i ligjshmërisë së përdorimit të votave të fituara nga subjekti politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” në qendrat e votimit nr.2043 – Reçan, 2044 – Lubinjë e Epërme, 2045 – Lubinjë e Poshtme, 2046 – Manastiricë, 2049 – Gërçar dhe 2071 - Planjanë, në Komunën e Prizrenit, për realizimin e vendit të garantuar për përfaqësimin e komunitetit serb në Kuvendin e Republikës së Kosovës. Parashtruesja e ankesës ka pretenduar se votat e subjektit politik të lartpërmendur janë realizuar në vendbanime me shumicë të komunitetit boshnjak, në të cilat sipas të dhënave zyrtare demografike, komuniteti serb nuk ka prani reale apo relevante. Sipas saj, ky fakt krijon dyshime lidhur me përdorimin e këtyre votave për llogaritjen e mandatit të garantuar për komunitetin serb dhe rrjedhimisht, paraqet nevojën për verifikimin nëse ka ardhur deri te keqpërdorimi i mekanizmit kushtetues të vendeve të garantuara dhe cenimi i përfaqësimit autentik të komuniteteve jo shumicë.

Nga PZAP, parashtruesja e ankesës ka kërkuar që ankesa të aprovohet si e bazuar në pjesën që ka të bëjë me verifikimin e votave të subjektit politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” për realizimin e vendit të garantuar, të urdhërohet verifikimi i hollësishëm i rezultateve në qendrat e kontestuara të votimit, rinumërimi dhe verifikimi i fletëvotimeve, formularëve të harmonizimit të rezultateve, procesverbaleve të këshillave të vendvotimeve dhe materialit përcjellës zgjedhor. Gjithashtu ka kërkuar nga KQZ-ja dokumentacionin e plotë lidhur me certifikimin e subjektit politik në fjalë, përfshirë deklarin nëse subjekti ka aplikuar për vendet e garantuara dhe për cilin komunitet, të konstatojë nëse ka ardhur deri te keqpërdorimi i mekanizmit kushtetues të vendeve të garantuara përmes mbështetjes vendimtare në vota nga mjediset ku komuniteti për të cilin garantohej vendi nuk ka prani reale demografike si dhe ndërmarrjen e masave për korrigjimin e rezultateve, përjashtimin e votave të kontestuara nga llogaritja për realizimin e vendit të garantuar apo anulimin e rezultateve në vendvotimet konkrete, nëse konstatohet se janë plotësuar kushtet ligjore.

Në përgjigjen e saj në ankesë, KQZ-ja ka sqaruar se liria dhe e drejta e votës në Republikën e Kosovës garantohej me Kushtetutë dhe me legjislacionin që rregullon procesin zgjedhor. Sipas KQZ-së, sistemi zgjedhor i Republikës së Kosovës nuk e kushtëzon të drejtën e votës me përkatësinë etnike të votuesit dhe Republika e Kosovës nuk është e organizuar në zona zgjedhore mbi baza etnike. KQZ-ja ka theksuar se legjislacioni në fuqi nuk parashihet mekanizëm që e lidh ose e kushtëzon votën e qytetarit me identitetin e tij etnik, pasi e drejta e votës përfaqëson një akt individual të shprehjes së lirë të vullnetit politik dhe nuk mund të



paragjykohet, kufizohet apo vlerësohet në bazë të përkatësisë etnike të votuesit. KQZ më tej ka theksuar se pretendimet e parashtrueses së ankesës, sipas të cilave rezultatet zgjedhore në qendrat e votimit të specifikuara nuk përputhen me strukturën demografike të popullsisë, nuk përbëjnë bazë ligjore për kontestimin e vlefshmërisë së votave apo të rezultatit zgjedhor, pasi që Lista e Votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve dhe në kuadër të administrimit të procesit zgjedhor, KQZ nuk mbledh, nuk ruan dhe nuk përpunon të dhëna që lidhen me etninë e votuesve. Rrjedhimisht sipas saj, nuk ekziston bazë ligjore dhe faktike për nxjerrjen e përfundimeve lidhur me votuesit mbi bazën e përkatësisë etnike të tyre.

PZAP, në arsyetim të vendimit të atakuar ndër të tjera ka theksuar se, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, pretendimeve ankimore të parashtrueses së ankesës, përgjigjes së KQZ-së dhe shkresave të tjera të lëndës, ka ardhur në përfundim se ankesa është e pabazuar. Paneli ka vlerësuar se pretendimet sipas së cilave subjekti politik "Za Slobodu, Pravdu i Opstanak" ka fituar në mënyrë të çrregullt vota në vendbanime ku, sipas të dhënave demografike, nuk ka anëtarë ose nuk ka prani relevante të komunitetit serb, nuk mund të shërbejnë në vetvete, si bazë për anulimin e votave apo shpalljen të pavlefshme të fletëvotimeve.

Paneli ka vlerësuar se e drejta e votës mbështetet në parimet e barazisë dhe fshehtësisë së votës dhe se Lista e Votuesve nuk përmban të dhëna për përkatësinë etnike të votuesve. Duke iu referuar nenit 6, paragrafi 2 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, sipas të cilit vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë, PZAP ka vlerësuar se nuk mund të paragjykohet se për cilin subjekt politik do të votojë një votues vetëm mbi bazën e përkatësisë së tij etnike. Po ashtu, PZAP ka theksuar se sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, i gjithë territori i Republikës së Kosovës përbën një zonë të vetme zgjedhore, ndërsa legjislacioni zgjedhor nuk parasheh kufizim të së drejtës së votës mbi bazën e përkatësisë etnike të votuesit. Për këtë arsye, Paneli ka vlerësuar se nuk ekziston bazë ligjore mbi të cilën do të mund të shpalleshin të pavlefshme fletëvotimet në vendvotime të caktuara duke u mbështetur në supozime për përkatësinë etnike të votuesve apo në krahasim ndërmjet numrit të votave të fituara nga një subjekt politik dhe numrit të pjesëtarëve të komunitetit të cilin ai deklaron se e përfaqëson.

Paneli duke iu referuar edhe nenit 45 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, ka vlerësuar se çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën 18 vjeçare, gëzon të drejtën për të zgjedhur dhe për tu zgjedhur, ndërsa vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë. Në këtë kuptim PZAP, ka vlerësuar se anulimi i votave apo shpallja e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të mbështetet në bazë të qartë ligjore dhe në prova konkrete, ndërsa pretendimet e mbështetura vetëm në strukturën demografike nuk përmbushin këtë standard.

PZAP-i është mbështetur edhe në praktikën e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, përkatësisht në Aktgjykimin KI69/2021, duke theksuar se sipas GJEDNJ-së nuk është detyrë e gjykatave të përcaktojnë vullnetin e votuesve përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë ligjore dhe se çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore. Në fund PZAP-i ka vlerësuar se parashtruesja e ankesës nuk ka bashkëngjitur prova të qarta dhe bindëse që do të dëshmonin pretendimet e saj, ashtu si kërkohet me nenin 117, paragrafi 3 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Sipas vlerësimit të Panelit, parashtruesja nuk ka arritur të bëjë të besueshme me prova bindëse se votat për



komunitetin boshnjak janë manipuluar apo orkestruar, ndërsa pretendimet e saj janë vlerësuar si deklarative dhe të paargumentuara. Për këto arsye PZAP e ka refuzuar ankesën si të pabazuar.

Gjykata Supreme e Kosovës, duke u nisur nga gjendja e tillë faktike dhe juridike e çështjes, e pranon në tërësi si të drejtë dhe të bazuar qëndrimin juridik të PZAP-it, të dhënë në vendimin ZP.Anr.58/2026, të datës 01.07.2026, lidhur me refuzimin e ankesës së subjektit politik Nova Demokratska Stranka – NDS, të përfaqësuar nga kryetarja dhe përfaqësuesja e autorizuar Emilija Rexhepi, të paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve – KQZ nr.01/1375-2026, të datës 27.06.2026, lidhur me shpalljen e rezultateve përfundimtare të Zgjedhjeve të Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, të mbajtura më 07.06.2026.

Gjykata Supreme vlerëson se vendimi i PZAP-it është i drejtë, i kuptueshëm dhe përmban arsye të mjaftueshme lidhur me faktet vendimtare, ndërsa nga gjendja faktike e vërtetuar rezultojnë se e drejta materiale është zbatuar drejt, në kuptim të dispozitave të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, të interpretuara në ndërlidhje me dispozitat kushtetuese që garantojnë karakterin personal, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë të votës, si dhe sistemin kushtetues të mbrojtjes dhe përfaqësimit institucional të komuniteteve që nuk janë shumicë në Republikën e Kosovës.

Pretendimet e ngritura në ankesë lidhur me përdorimin e votave të realizuara nga subjekti politik “Za Slobodu, Pravdu i Opstanak” – ZSPO, në gjashtë qendra votimi në vendbanimet Reçan, Lubinjë e Epërme, Lubinjë e Poshtme, Manastiricë, Gërçar dhe Planjanë të Komunës së Prizrenit, për realizimin e një vendi të garantuar për përfaqësimin e komunitetit serb, Gjykata Supreme i vlerëson si të pabazuara. Kjo për faktin se pretendimet e palës ankuese mbështeten në mospërputhjen ndërmjet numrit të votave të realizuara nga subjekti politik ZSPO në qendrat e lartcekura dhe të dhënave mbi strukturën demografike të popullsisë së vendbanimeve përkatëse. Mirëpo, një mospërputhje e tillë statistikore nuk përbën bazë ligjore për vënien në dyshim të vlefshmërisë së votave ose të rezultatit zgjedhor. Legjislacioni zgjedhor në fuqi nuk e përcakton strukturën etnike të popullsisë së një vendbanimi si kriter për vlerësimin e ligjshmërisë së votës, për përcaktimin e përkatësisë etnike të votuesit apo për përcaktimin e efektit juridik të votës së tij.

Ankuesja në ankesën e paraqitur i është referuar shkeljeve esenciale të procedurës, zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, konstatimit jo të plotë të gjendjes faktike, zbatimit të pabarabartë të standardit juridik dhe cenimit të qëllimit kushtetues të vendeve të garantuara, duke pretenduar se PZAP-i ka keqkuptuar objektin e ankesës së saj, pasi që ajo ka theksuar se nuk ka kërkuar përcaktimin e përkatësisë etnike të votuesve individualë dhe as anulimin e votave mbi këtë bazë, por verifikimin institucional të ligjshmërisë së përdorimit të 203 votave të realizuara nga subjekti politik ZSPO në gjashtë vendbanimet e lartcekura, për realizimin e një mandati të garantuar për komunitetin serb.

Gjykata Supreme vlerëson se, pavarësisht mënyrës së formulimit të kërkesës, pasoja juridike që synohet nga ankuesja është që raporti ndërmjet strukturës demografike të vendbanimeve përkatëse dhe numrit të votave të fituara nga subjekti politik ZSPO të ndikojë në vlefshmërinë ose llogaritjen e këtyre votave për realizimin e mandatit të garantuar. Një pasojë e tillë juridike



nuk mund të nxirret pa ekzistimin e një baze të qartë kushtetuese dhe ligjore, e cila në rastin konkret mungon.

Neni 45 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës përcakton se: *"1. Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjidhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor. 2. Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë."* Nga përmbajtja e kësaj dispozite kushtetuese rezulton se vullneti politik i qytetarit është individual dhe se ushtrimi i tij nuk mund të kushtëzohet nga përkatësia etnike e votuesit. Karakteri personal, i barabartë, i lirë dhe i fshehtë i votës nënkupton se votuesi e ushtron të drejtën e tij zgjedhore individualisht dhe është i lirë të votojë për subjektin politik sipas vullnetit të tij. Rrjedhimisht, nuk mund të prezumohet se një qytetar, vetëm për shkak të përkatësisë së tij në një komunitet të caktuar, është i detyruar të votojë për subjektin politik që deklaron se përfaqëson atë komunitet. Në të njëjtën mënyrë, një votë e dhënë për një subjekt tjetër politik nuk humb dhe nuk ndryshon efektin e saj juridik vetëm për shkak të përkatësisë etnike të personit që e ka dhënë atë.

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson si të drejtë dhe të ligjshëm konstatimin e PZAP-it se në rastin konkret, sipas Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnitetin e votuesve përkatësisht të votimit. Në anën tjetër, edhe për kolegjin e kësaj gjykate është i drejtë dhe i ligjshëm konstatimi i PZAP-it lidhur me pretendimet e palës ankuese se nuk ka asnjë bazë ligjore për shpalljen e pavlefshme të fletëvotimeve në vendvotimet e lartcekura, duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve, përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaron që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Po ashtu, Gjykata Supreme ka vlerësuar të drejtë konstatimin dhe vlerësimin e PZAP-it, se referuar Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Kosovë, Lista e votuesve nuk përmban të dhëna për komunitetet etnike në Kosovë, rrjedhimisht KQZ nuk bën grumbullim apo përpunim të dhënash për etnicitetin e votuesve.

Në raport me pretendimet e ankueses për mbrojtjen e komuniteteve që nuk janë shumicë, Gjykata Supreme mori parasysh edhe nenet 57, 58 dhe 59 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës. Këto dispozita krijojnë një sistem të veçantë kushtetues të mbrojtjes së komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre dhe garantojnë ruajtjen, mbrojtjen dhe zhvillimin e identitetit të tyre, si dhe ushtrimin e të drejtave të veçanta kushtetuese. Mirëpo, këto garanci nuk mund të interpretohen të shkëputura nga neni 45 i Kushtetutës. Mbrojtja kushtetuese e komuniteteve dhe pjesëtarëve të tyre nuk e ndryshon karakterin individual të së drejtës së votës dhe nuk krijon bazë për kategorizimin juridik të votës sipas përkatësisë etnike të votuesit.

Në vazhdim, neni 64 i Kushtetutës përcakton mekanizmin e përfaqësimit të komuniteteve që nuk janë shumicë në Kuvendin e Republikës së Kosovës, duke garantuar njëzet nga njëqind e njëzet vendet për përfaqësimin e këtyre komuniteteve. Qëllimi i kësaj dispozite është sigurimi i përfaqësimit institucional të komuniteteve që nuk janë shumicë. Megjithatë, neni 64 nuk përmban rregull sipas të cilit vota e dhënë për një subjekt politik që konkurren për një vend të garantuar mund të prodhojë efekt juridik vetëm nëse është dhënë nga një votues i komunitetit përkatës. Prandaj, sipas vlerësimit të Gjykatës Supreme, neni 45 dhe nenet 57, 58, 59 dhe 64

të Kushtetutës duhet të interpretohen në harmoni me njëra-tjetrën dhe si një tërësi normative. Nga ky interpretim rezulton se Kushtetuta, nga njëra anë, garanton votën personale, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë dhe, nga ana tjetër, garanton mbrojtjen dhe përfaqësimin institucional të komuniteteve që nuk janë shumicë. Mirëpo, mekanizmi kushtetues i vendeve të garantuara nuk e shndërron votën individuale në votë etnikisht të kategorizuar dhe nuk u jep organeve zgjedhore ose gjykatave autorizim që të përcaktojnë përkatësinë etnike të votuesve, të supozojnë mënyrën se si ata është dashur të votojnë apo t'i japin ose t'i mohojnë efekt juridik një vote në varësi të përkatësisë etnike të supozuar të personit që e ka dhënë atë.

Në rastin konkret, Gjykata Supreme vlerëson se pretendimi sipas të cilit 203 votat e realizuara nga subjekti politik ZSPO në qendrat e votimit në Reçan, Lubinjë të Epërme, Lubinjë të Poshtme, Manastiricë, Gërçar dhe Planjanë duhet t'i nënshtrohen një verifikimi të posaçëm institucional vetëm për shkak të raportit ndërmjet numrit të votave dhe strukturës demografike të këtyre vendbanimeve, nuk gjen mbështetje të drejtpërdrejtë në dispozitat kushtetuese të lartcekura. Fakti se, sipas të dhënave të paraqitura nga ankuesja, në gjashtë vendbanimet përkatëse janë evidentuar gjithsej vetëm 6 pjesëtarë të komunitetit serb, ndërsa subjekti ZSPO ka realizuar 203 vota, nuk mund të çojë, në aspektin juridik, në përfundimin se votat e tjera janë të kundërligjshme, të pavlefshme ose të papërshtatshme për t'u përllogaritur në rezultatin zgjedhor. Një përfundim i tillë do të kërkonte, së pari, ekzistimin e një norme juridike që e lidh efektin e votës me përkatësinë etnike të votuesit dhe, së dyti, prova konkrete për ekzistimin e shkeljeve zgjedhore, ndërsa në rastin konkret asnjëra nga këto kushte nuk është plotësuar.

Gjykata Supreme iu referua edhe dispozitave të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës. Neni 6 paragrafi 2 i këtij ligji përcakton: "*Vota është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë.*" Kjo dispozitë ligjore, në pajtim me garancinë e nenit 45 të Kushtetutës, përjashton mundësinë që vota individuale të trajtohet juridikisht si votë e lidhur me përkatësinë etnike të votuesit. Nga kjo dispozitë rezulton se votuesi është i lirë ta ushtrojë të drejtën e tij zgjedhore sipas vullnetit të vet dhe se ligji nuk paragjykon se për cilin subjekt politik duhet të votojë ai në bazë të përkatësisë së tij etnike.

Përkitazi me pretendimin e ankueses se objekti i ankesës nuk është përcaktimi i përkatësisë etnike të votuesve individualë, por verifikimi i përdorimit institucional të votave për realizimin e një mandati të garantuar, Gjykata Supreme mori parasysh edhe nenin 16 paragrafi 12 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, i cili përcakton se: "*Çdo subjekt politik në kërkesën e tij tregon nëse dëshiron të hyjë në garë për të fituar ndonjërin prej vendeve të garantuara për përfaqësim të serbëve dhe komuniteteve tjera jo shumicë të Kosovës, sipas nenit 64 të Kushtetutës.*" Gjykata Supreme vlerëson se kjo dispozitë rregullon statusin dhe deklarin e subjektit politik në procesin zgjedhor, mirëpo nuk përmban rregull sipas të cilit vetëm pjesëtarët e komunitetit të caktuar mund të votojnë për subjektin politik që merr pjesë në ndarjen e vendeve të garantuara për atë komunitet. Po ashtu, kjo dispozitë nuk krijon mekanizëm juridik për identifikimin e përkatësisë etnike të votuesve pas ushtrimit të votës dhe as kriter sipas të cilit votat e një subjekti politik mund të përjashtohen nga llogaritja e rezultatit zgjedhor mbi bazën e strukturës demografike të vendbanimit ku ato janë dhënë.

Neni 110 i Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton se: "*Kosova është një zonë e vetme zgjedhore.*" Kjo nënkupton se ushtrimi i së drejtës së votës dhe përcaktimi i rezultatit zgjedhor zhvillohen brenda një njësie të vetme zgjedhore dhe se vota

e vlefshme prodhon efekt juridik sipas rregullave të njëjta, pavarësisht qendrës së votimit apo vendbanimit në të cilin është dhënë. Në këtë kuptim, qendrat e votimit dhe vendvotimet nuk përbëjnë zona të veçanta zgjedhore dhe as njësi juridike mbi bazën e të cilave mund të përcaktohet përkatësia etnike e votuesve apo efekti juridik i votave të tyre. Për rrjedhojë, struktura demografike e një vendbanimi të caktuar nuk mund të shërbejë si kriter juridik për të përcaktuar se cilit komunitet i përket votuesit që kanë votuar në qendrat e votimit të atij vendbanimi, për cilin subjekt politik është dashur të votojnë apo nëse votat e tyre mund të merren parasysh në përcaktimin e rezultatit përfundimtar zgjedhor.

Ky karakter i sistemit zgjedhor përforcon përfundimin se krahasimi ndërmjet numrit të pjesëtarëve të një komuniteti të evidentuar në një vendbanim të caktuar dhe numrit të votave të realizuara aty nga një subjekt politik që deklaron se përfaqëson atë komunitet nuk mund të prodhojë pasoja juridike mbi vlefshmërinë apo përlogaritjen e votave. Një qasje e kundërt do të nënkuptonte krijimin e një lidhjeje juridike ndërmjet vendbanimit, përkatësisë etnike të supozuar të votuesit dhe subjektit politik për të cilin ai mund të votojë, lidhje e cila nuk parashihet as nga Kushtetuta dhe as nga legjislacioni zgjedhor në fuqi. Prandaj, fakti se në gjashtë qendrat e votimit të lartcekura subjekti politik ZSPO ka realizuar 203 vota, ndërsa ankuesja, duke iu referuar të dhënave demografike, pretendon se në vendbanimet përkatëse janë evidentuar vetëm 6 pjesëtarë të komunitetit serb, nuk përbën bazë të mjaftueshme juridike për të vënë në dyshim ligjshmërinë e këtyre votave. Në një sistem me një zonë të vetme zgjedhore, vendndodhja e qendrës së votimit nuk përcakton identitetin etnik të votuesit dhe as nuk kufizon lirinë e tij për të votuar për cilindo subjekt politik të certifikuar. Çdo vlerësim i kundërt do të binte ndesh me karakterin personal, të barabartë, të lirë dhe të fshehtë të votës, të garantuar me nenin 45 të Kushtetutës dhe nenin 6 paragrafi 2 të Ligjit nr.08/L-228.

Neni 117 paragrafi 3 i Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton shprehimisht se: *“Vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse.”* Kjo dispozitë kërkon që pretendimi për ekzistimin e një shkeljeje zgjedhore të mbështetet në prova konkrete, të besueshme dhe të mjaftueshme, të cilat dëshmojnë ekzistimin e një shkeljeje të caktuar të procesit zgjedhor dhe lidhjen e saj me rezultatin e kontestuar. Në rastin konkret, të dhënat e ASK/ReKos 2024, rezultatet zgjedhore sipas qendrave të votimit dhe tabela krahasuese e paraqitur nga ankuesja nuk përmbushin standardin e dëshmimeve të qarta dhe bindëse për vërtetimin e një shkeljeje konkrete zgjedhore. Nga këto të dhëna nuk është vërtetuar manipulimi i fletëvotimeve, ndërhyrja në kutitë e votimit apo ndonjë veprim tjetër konkret i kundërligjshëm që do të kishte ndikuar në ligjshmërinë e rezultatit zgjedhor.

Vetë disproporcioni statistikor ndërmjet strukturës demografike të një vendbanimi dhe numrit të votave të realizuara nga një subjekt politik nuk përbën, pa prova të tjera konkrete, dëshmi të qartë dhe bindëse për ekzistimin e një shkeljeje zgjedhore. Për rrjedhojë, Gjykata Supreme vlerëson se të dhënat demografike dhe rezultatet numerike, të analizuar pa prova të drejtpërdrejta për parregullsi zgjedhore, nuk mund të shërbejnë si bazë për cenimin e prezumimit të vlefshmërisë së votave dhe as për ndërhyrjen në rezultatin zgjedhor.

Më tej, neni 118 paragrafi 1 i Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës përcakton se: *“PZAP-ja pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin kriteret e miratuara paraprakisht”*, ndërsa paragrafi 2 i të njëjtit nen

përcakton se: "PZAP-ja ofron bazat ligjore dhe faktike për vendimet e tij me shkrim." Nga ndërlidhja e nenit 117 paragrafi 3 me nenin 118 paragrafët 1 dhe 2 të Ligjit, Gjykata Supreme vlerëson se PZAP-i kishte detyrim t'i vlerësonte pretendimet e ankueses në raport me faktet dhe provat konkrete të paraqitura dhe të përcaktonte nëse ato arrinin standardin ligjor të dëshmive të qarta dhe bindëse. Në rastin konkret, PZAP-i, pasi ka shqyrtuar pretendimet dhe materialin provues të paraqitur, ka vlerësuar se nuk janë provuar shkelje konkrete të procesit zgjedhor dhe se pretendimet e ankueses mbështeten kryesisht në krahasimin ndërmjet rezultateve zgjedhore dhe të dhënave demografike, vlerësim i cili sipas Gjykatës Supreme, është juridikisht i drejtë.

Gjykata Supreme nuk e gjen të bazuar pretendimin se PZAP-i ka qenë i detyruar të ndërmarrë verifikim shtesë institucional vetëm mbi bazën e disproporcionit të pretenduar statistikor. Fakti se organi vendimmarrës nuk u ka dhënë provave efektin juridik të kërkuar nga ankuesja nuk nënkupton se ato nuk janë shqyrtuar apo se gjendja faktike ka mbetur e pa konstatuar. Nga shkresat e lëndës rezulton se PZAP-i i ka shqyrtuar pretendimet e ankueses dhe materialin provues të paraqitur, mirëpo ka vlerësuar se ato nuk përbëjnë bazë ligjore për të vërtetuar ndonjë shkelje konkrete zgjedhore.

Kolegji i Gjykatës Supreme shqyrtoi edhe pretendimet e ankueses që i referohen praktikës së mëparshme vendimmarrëse në situata të ngjashme, përkatësisht vendimmarrjes së vitit 2021, duke përfshirë vendimet e PZAP-it A.nr.656/2021 dhe A.nr.736/2021, mirëpo erdhi në përfundim se të njëjtat janë të pabazuara. Kjo për faktin se, referuar shkresave të lëndës, përkatësisht vendimit të atakuar të PZAP-it, rezulton se ky i fundit për çështjen kontestuese me të drejtë i është referuar aktgjykimit të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës, të datës 26.05.2023, në rastin nr.KI69/21 Parashtrues Partia Liberale Egjiptiane (PLE) dhe Partia Rome e Bashkuar e Kosovës (PREBK). Në lidhje me këtë, përkatësisht për çështjet e ngritura me ankesë nga këtu ankuesja, Gjykata Kushtetuese në pikën 196 të këtij aktgjykimi, ka theksuar se: "*.... në kuadër të sistemit aktual zgjedhor në Republikën e Kosovës nuk ka asnjë bazë mbi bazën e të cilës do të mund të shpallen të pavlefshme fletëvotime në vendvotime të caktuara duke u bazuar mbi supozime për përkatësinë etnike të votuesve përfshirë proporcionin në mes numrit të fletëvotimeve që mund të ketë fituar një parti, koalicion, nismë qytetare dhe kandidat i pavarur që deklaroi që përfaqëson një komunitet dhe numrit të kalkuluar të votuesve të të njëjtit komunitet në vendvotime të caktuara. Gjykata rikujton që sipas GJENDJ-së (i) nuk është detyrë e gjykatave që të përcaktojnë vullnetin e votuesve, përfshirë përmes shpalljes së pavlefshme të fletëvotimeve pa bazë të saktë dhe (ii) çdo shpallje e pavlefshme e fletëvotimeve duhet të jetë e bazuar në bazë të saktë ligjore, kërkesë kjo që buron edhe nga vet Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe rregullativa e KQZ-së në kontekst të kompetencës së PZAP-së, për të anuluar/shpallur të pavlefshme fletëvotime."* Ndërsa në pikën 198 të këtij aktgjykimi është konstatuar se: "*Përfundimisht, Gjykata rithekson që vota në Republikën e Kosovës është personale, e barabartë, e lirë dhe e fshehtë dhe si e tillë nuk mund të anulohet/shpallet e pavlefshme bazuar në përkatësi etnike të votuesit."*

Gjykata Supreme vlerëson se, në pajtim me nenin 4 paragrafi 6 në lidhje me nenin 112 paragrafi 1 të Kushtetutës, Gjykata Kushtetuese është autoriteti përfundimtar në Republikën e Kosovës për interpretimin e Kushtetutës dhe përputhshmërinë e ligjeve me Kushtetutën, si dhe bazuar në nenin 116 paragrafi 1, të kushtetutës ku shprehimisht përcaktohet se: "*Vendimet e Gjykatës*

Kushtetuese janë të detyrueshme për gjyqësorin dhe të gjithë personat dhe institucionet e Republikës së Kosovës". Për rrjedhojë, vendimmarrja në çështjen konkrete duhet të jetë në pajtim me standardet e përcaktuara në Aktgjykimin KI69/21 të Gjykatës Kushtetuese.

Mbi këtë bazë, Gjykata Supreme i vlerëson të pabazuara pretendimet ankimore se vendimi i PZAP-it ka cenuar qëllimin kushtetues të vendeve të garantuara dhe se mosndërhyrja në rastin konkret krijon rrezik për majorizim. Mbrojtja kushtetuese e komuniteteve jo shumicë dhe mekanizmi i vendeve të garantuara nuk mund të interpretohen si bazë për kufizimin e së drejtës individuale të votës ose për përcaktimin e efektit juridik të saj në varësi të përkatësisë etnike të supozuar të votuesit. Mbrojtja dhe përfaqësimi i komuniteteve duhet të realizohen në kuadër të mekanizmave të përcaktuar shprehimisht me Kushtetutë dhe ligj, ndërsa gjykata nuk mund të krijojë një kriter të ri të vlefshmërisë ose të efektit të votës që nuk është paraparë nga legjislacioni zgjedhor në fuqi.

Gjykata Supreme vlerëson se për ndërhyrje në rezultatin zgjedhor kërkohet bazë konkrete ligjore dhe ekzistimi i dëshmive të qarta dhe bindëse për një shkelje të caktuar të procesit zgjedhor. Në rastin konkret, ankuesja nuk ka paraqitur prova që dëshmojnë manipulim të fletëvotimeve, ndërhyrje në kutitë e votimit, apo ndonjë veprim tjetër të kundërligjshëm që ka ndikuar në rezultatin zgjedhor. Për rrjedhojë, krahasimi ndërmjet të dhënave demografike dhe numrit të votave të realizuara nga subjekti politik ZSPO nuk është i mjaftueshëm për të prodhuar pasojat juridike të kërkuara nga ankuesja.

Nisur nga gjendja faktike e vërtetuar, Gjykata Supreme e Kosovës konstaton se gjendja faktike është vërtetuar drejt dhe se ligji nuk është shkelur në dëm të parashtrueses së ankesës, prandaj pretendimet ankimore janë refuzuar si të pabazuara. Pretendimet e paraqitura në ankesë nuk dëshmojnë ekzistimin e ndonjë shkeljeje konkrete të procesit zgjedhor, ndërsa mospërputhja statistikore ndërmjet rezultateve zgjedhore dhe strukturës demografike të vendbanimeve, në mungesë të një baze të qartë ligjore dhe të provave konkrete për parregullsi zgjedhore, nuk mund të prodhojë pasoja juridike mbi vlefshmërinë e votave apo rezultatin zgjedhor.

Nga theksimet si më lart dhe në bazë të nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA SUPREME E KOSOVËS

AA.nr.31/2026, datë 06.07.2026

Kryetari i kolegjit
Faton Bajrami



Republika e Kosovës
Republika Kosovo
SAKTËSINË E KOPJËS E VËRTETON
TAČNOST OTPRAVKA POTVRDUJE

Runëtori i autorizuar
Ovlašćeni radnik